

SEKSIONI XV

METALET BAZË DHE ARTIKUJT PREJ METALEVE BAZË

Shënim

1. Ky Seksion nuk përfshin:

- (a) Bojërat dhe ngjyrosësit e përgatitur apo produkte të tjera me bazë të fetëzave apo të pluhurit metalik (krerët 3207 deri 3210, 3212, 3213 apo 3215);
- (b) Ferro-cerriume apo lidhje të tjera piroforike (kreu 3606);
- (c) Veshjet e kokës apo pjesët e tyre të kreut 6506 apo 6507;
- (d) Skelet e çadrave apo artikuj të tjerë të kreut 6603;
- (e) Mallërat e Kapitullit 71 (psh, lidhjet e metaleve të çmuar, veshjet e metaleve bazë me metal të çmuar, imitacionet e bizhuterive);
- (f) Artikujt e Seksionit XVI (makineritë, pajisjet mekanike dhe mallërat elektrike);
- (g) Shinat hekurudhore apo të tramvajeve (kreu 8608) apo artikuj të tjerë të Seksionit XVII (mjetet e transportit detar, tokësor dhe ajror);
- (h) Instrumentet apo aparatat e Seksionit XVIII, përfshirë zembekët e orëve të murit dhe të dorës;
- (ij) Plumbat prej plumbi të përgatitur për municion (kreu 9306) apo të tjerë artikuj të Seksionit XIX (armët dhe municionet);
- (k) Artikujt e Kapitullit 94 (psh, mobilet, përshtatësit e shtretërve, llampat dhe pajisjet ndriçuese, shenjat ndriçuese, ndërtesat parafabrikat);
- (l) Artikujt e Kapitullit 95 (psh, lodrat, pajisjet e lojërave dhe të sportit);
- (m) Siat e dorës, butonet, lapsat, mbajtësit e lapsave, majat e penave, monopodet, bipodet, tripodet dhe aartikujt e ngjashëm apo artikujt tjetër të Kapitullit 96 (artikuj të ndryshëm të prodhuar); apo
- (n) Artikujt e Kapitullit 97 (psh, veprat e artit).

2. Gjatë gjithë Nomenklaturës, shprehja "**pjesët e përdorimit të përgjithshëm**" nënkupton:

(a) Artikujt e kreut 7307, 7312, 7315, 7317 apo 7318 dhe artikuj të tjerë të ngjashëm prej metaleve bazë;

(b) Sustat dhe fletat e sustave, prej metali bazë, përveçse zembereku i orëve të murit dhe të dorës (kreu 9114); dhe

(c) Artikujt e krerëve 8301, 8302, 8308, 8310 dhe skeletet dhe pasqyrat, prej metali bazë, të kreut 8306.

Në Kapitujt 73 deri 76 dhe 78 deri 82 (por jo në kreun 7315) referencat për pjesët e mallërave nuk përfshijnë referencat për pjesët e përdorimit të përgjithshëm siç u përcaktua më lartë.

Nënshtuar ndaj paragrafit të sipërshkuar dhe të Shënimit 1 të Kapitullit 83, artikujt e Kapitullit 82 apo 83 janë të përjashtuara nga Kapitujt 72 deri 76 dhe 78 deri 81.

3. Gjatë gjithë Nomenklaturës, shprehja "**metale bazë**" nënkupton: gizë dhe çelik, bakër, nikel, alumin, plumb, zink, kallaj, tungsten (volfram), molibden, tantalum, magnez, kobalt, bismuth, kadmium, titanium, zirkonium, antimon, manganez, berilium, krom, germanium, vanadium, gallium, hafnium, indium, niobium (kolombium), renium dhe talium.

4. Gjatë gjithë Nomenklaturës, termi "**metaloqeramika**" nënkupton produktet që përmbajnë një kombinim mikroskopik heterogjen prej një komponenti metalik dhe një komponenti qeramik. Termi "metaloqeramika" përfshin karbitet e metaleve të shkrirshme (karbiti metalik të shkrirë me një metal).

5. **Klasifikimi i lidhjeve** (përveçse ferro-lidhjeve dhe master lidhjeve siç janë të përcaktuara në Kapitujt 72 dhe 74):

(a) Një lidhje prej metaleve bazë do të klasifikohet si një lidhje e metalit i cili predominon ndaj peshës mbi çdo nga metalet e tjera;

(b) Një lidhje e përbërë nga metalet bazë të këtij Seksioni dhe prej elementeve që nuk përfshihen në këtë Seksion do të trajtohen si një lidhje prej metaleve bazë të këtij Seksioni nëse pesha totale e metaleve të tillë është e barabartë apo e tejkalon peshën totale të elementeve të tjerë prezent;

(c) Në këtë Seksion termi "**lidhje**" përfshin përzierjet e shkrirshme të pluhurave metalike, përzierjet heterogjene të lidhura ngushtë fituar nga shkrirja (përveçse metaloqeramikat) dhe përbërjet ndërmetalike.

6. Derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, çdo referencë në Nomenklaturë për metalet bazë përfshin një referencë për lidhjet të cilat, sipas Shënimit 3 më lartë, do të klasifikohen si lidhje të atij metali.

7. Klasifikimi i artikujve të përbërë:

Veçse kur kreu e kërkon ndryshe , artikujt prej metaleve bazë (përfshirë artikujt e materialeve të përziera të trajtuara si artikuj prej metaleve bazë sipas Rregullave të Përgjithshme Interpretative) që përmbajnë dy apo më shumë metale bazë do të trajtohen si artikuj të atij metali bazë i cili predominon në peshë mbi çdo metal tjetër bazë.

Për këtë qëllim:

- (a) Giza dhe çeliku, apo lloje të ndryshëm të gizës dhe të çelikut, do të vlerësohen si një dhe i njeiti metal;
- (b) Një lidhje do të vlerësohet sikur është e përbërë tërësisht nga ai metal sipas të cilit do të klasifikohet kjo lidhje, në bazë të Shënimit 5;
- (c) Një metaloqeramik i kreut 8113 do të vlerësohet si një metal i vetëm bazë.

8. Në këtë Seksion, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë ngjitur me to:

- (a) Mbetje dhe Kthime.

Mbetje dhe kthime metali nga përpunimi apo puna mekanike që u është bërë metaleve, dhe mallërat metalike definitivisht të papërdorshme si të tillë për arsye të thyerjes, prerjes, konsumimit fizik apo arsye të tjera.

- (b) Pluhura

Produktet prej të cilave 90 % apo më shumë ndaj peshës kalon nëpërmjet një site me diametër prej 1mm.